



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË OBILIQIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit

Adresa: Rr.Adem Jashari nr. 2, Obiliq, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit (Komuna e Obiliqit), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Obiliqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komuna e Obiliqit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

1. Komuna gjatë vitit 2020 kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 79,653€ nga kategori ekonomike jo adekuate si në vijim:

Nga buxheti i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve janë paguar 45,021€ në emër të pagave jubilarë dhe 25,732€ për kompensime shtesë për të punësuarit. Po ashtu edhe blerja e softuerit financiar në vlerë prej 8,900€, e që i takon investimeve kapitale, është paguar nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve përkatësisht nga kodi ekonomik 13460– shërbime kontraktuese tjera.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zyrtar Kryesor Financiarë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zyrtar Kryesor Financiarë është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Obiliqit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Obiliqit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Obiliqit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Obiliqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Obiliqit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalesjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Planifikimi i të hyrave vetjake për vitin 2020 ishte 1,022,665€, kurse realizimi ishte në vlerë prej 776,820€ apo 76 % krahasuar me planin. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë, etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat nga trafiku, gjykatat dhe agjencia e pyjeve në vlerë totale prej 104,348€, këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës. Vlen të theksohet se në këtë vit krahasuar me vitin e kaluar Komuna ka realizuar më pak të hyra prej 195,774€ apo shprehur në përqindje 20%. Zvogëlimi më i theksuar është tek tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, ndërrim destinimi i tokës, taksa për ushtrimin e veprimtarisë. Gjendja e pandemisë ishte shkaku që ka ndikuar në mbledhjen më të ulët të të hyrave.

Çështja A1 - Mos verifikimi (inspektimi) i pronave të regjistruara

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20%, e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.”

Komuna nuk ka bërë inspektimin e 20% të pronave të regjistruara, ku prej 6,428 pronave, gjatë vitit 2020 ka bërë inspektimin e vetëm 240 pronave, ose vetëm 3.7% të verifikimet të pronave.

Shkaku për këtë sipas zyrtarëve komunal ka qenë situata pandemike që është përcjelle me staf të reduktuar dhe mungesa e veturave zyrtare për ti inspektuar pronat sipas kërkesës ligjore

Ndikimi Inspektimi i ulët i pronave mund të rezultojë me informata jo të plota dhe jo të sakta të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që vlerësimet për tatimin në pronë të mos jenë të sakta.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave mbi pronën për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos pagesa e taksës për ushtrimin e veprimtarisë**Gjetja**

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal dhe neni 7 (pika 2) – “Gjobat për veprimtari afariste”, i “Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale me nr. I-94 (i datës 29.06.2018)”, përcakton se: ”Ndaj subjektit afarist i cili nuk bënë pagesën e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste të caktuar për vitin fiskal sipas afateve, do te iniciohet procedura gjyqësore në Gjykatën kompetente për ekzekutim të dhunshëm”.

Gjatë testimit të tetë rasteve, mos pagesa e taksës për ushtrimin e veprimtarisë nga ana e bizneseve ka shkaktuar borxhe të pa mbledhura, në vlerë prej 17,040€ (borxhe të akumuluar nëpër vite). Komuna për vitin 2020 ka pranuar vetëm 1,200€ të hyra apo 8% në raport me borxhin e sipër cekur, sepse nuk kishte ndërmarr masa apo ndonjë procedurë gjyqësore (përveç “Vërejtjes së fundit” që kishte aplikuar vitin e kaluar) për ekzekutim të dhunshëm të borxheve (komform legjislacionit).

Kjo situatë ka ndodh për shkak të vështirësive financiare të këtyre bizneseve, dhe mbledhja e të hyrave për këtë kategori tregon realizim të dobët.

Ndikimi

Realizimi i ulët i të hyrave nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë pamundëson Komunën ti mbledhë fondet e nevojshme dhe ti arrij objektivat apo përfitimet që ka planifikuar ti mbuloj nga këto taksa.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të monitoroj realizimin efektiv të të hyrave duke analizuar shkaqet e rritjes së llogarive të pa arkëtuara dhe me raste, të sigurojë që të iniciohen procedura nëpërmes gjykatës apo përmbaruesve për ti mbledhur borxhet nga bizneset.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë**

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 1,606,493€, prej tyre ishin shpenzuar 1,100,954€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime mjekësore, shërbime kontraktuese tjera, mirëmbajtje të objekteve, mirëmbajtje të parqeve, shpenzime komunale, furnizime për zyre etj. Kemi testuar 13 mostra për teste substanciale në vlerë 265,146€ si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Parregullsi në planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit**Gjetja**

Me pikën 8.6 të RRUOPP është përcaktuar që nëse aktiviteti i prokurimit nuk është përfshirë në planifikimin final të prokurimit, në rast të autoritetit publik ose ndërmarrjes publike, një kopje e formularit do të dërgohet nga ZKA te AQP të paktën 5 ditë para autorizimit nga Zyrtari Autorizues të Zyrtarit të Prokurimit për të iniciuar aktivitetin e prokurimit.

Sipas LPP dhe RRUOPP, për kontratat publike kornizë mos përputhja nga sasia apo vlera indikative e përcaktuar me kontratë është e lejuar deri -/+ 30 %. Ky kufizim vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për at Lot apo pozicion/artikull. Kemi identifikuar rastet si në vijim:

- Blerja e softuer-it financiar në vlerë 8,900€ nuk ishte planifikuar me planin vjetor të prokurimit, dhe as nuk ishte njoftuar AQP për këtë procedurë të prokurimit.
- Kontrata për “Furnizim me pajisje për institucionet shkollore”, në vlerë 33,436€, nuk ishte përfshirë në planin vjetor të prokurimit si aktivitet, dhe as nuk ishte njoftuar AQP. Po ashtu si kriter ishte kërkuar që OE duhet të kenë një saldues të çertifikuar ndërsa fituesi kishte sjellë dëshmi/çertifikatë të lëshuar nga një vend i huaj, e që ishte e pa nostrifikuar nga institucionet e vendit tonë.
- Te kontrata publike kornizë për “Furnizim me material mjekësor (ampullar, laboratorik, stomatologjik, radiologjik dhe gjinekologjik)” në vlerë 169,380€, me përshkrim të çmimeve apo paramasë, për produktin Dexamethasone 4mg amp im/iv, ishin planifikuar për furnizim 200 copë, ndërsa deri në fund të vitit 2020 sipas evidencës se menaxherit të kontratës ishin furnizuar 4,100 copë, duke e tejkaluar limitin e lejuar prej 30%.

Shkak i kësaj situatë ishte mungesa e kontrolleve të brendshme dhe planifikime jo adekuate nga njësitë kërkuese.

Ndikimi

Realizimi i prokurimeve jashtë planit si dhe mos njoftimi/informimi i AQP-së vështirësojnë realizimin e planit të prokurimit dhe krijojnë vështirësi financiare për Komunën. Po ashtu, edhe tejkalimi i furnizimeve krahas limiteve të lejuara për pozicion ndikon në dëmtimin apo mosrealizimin e pozicioneve tjera të kontraktuara.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që plani i prokurimit do të përfshijë të gjitha kërkesat nga njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit, dhe në raste specifike kur

aktiviteti nuk është përfshirë në plan, paraprakisht të njoftohet AQP. Po ashtu, Kryetari të sigurojë që kërkesat nga njësitë kërkuese të planifikohen në bazë të nevojave reale si dhe furnizimet përmes kontratave publike kornizë të mos tejkalojnë limitet e lejuara të devijimit prej +/-30%.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Ndarje jo e duhur e detyrave dhe parregullsi në menaxhimin e kontratave

Gjetja

LMFPP dhe Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF shpenzimi i parasë publike përcakton elementet thelbësore të shpenzimit të parasë publike, siç janë, ndarja buxhetore, alokimi, zotimi, prokurimi publik, obligimi dhe pagesat. Asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti ose marrëveshje nuk ekzekutohet si pagesë, nëse dokumenti apo marrëveshja e këtillë që rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuar me dispozitat e LMFP.

Gjithashtu me pikën 61 të RrUOPP janë përcaktuar përgjegjësit e menaxherit të kontratës. Menaxheri i Kontratës ka përgjegjësi të menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar me kontratë, dhe b) sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termet dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Po ashtu, UA nr. 15/2013 – përcakton kërkesat dhe kushtet për mbajtjen e librit dhe ditarit ndërtimor nga organi mbikëqyrës i punimeve. Me pikën 4 të RRUOPP është përcaktuar që një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose TER, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura, nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit.

- Te kontrata publike kornizë për “Eliminimin/pastrimin e deponimeve ilegale në territorin e Komunës së Obiliqit”, në vlerë indikative prej 17,093€, për punët e realizuara nuk ishte mbajtur libri ndërtimor, ndërsa në ditarët e punës nuk janë dhënë informata të mjaftueshme për sasinë e punës së kryer dhe informacione tjera relevante. Përveç nënshkrimit fillestar të Planit të Menaxhimit të Kontratës, e njëjta nuk ishte azhurnuar tutje me informatat tjera plotësuese rreth realizimit dhe përmbylljes së kontratës. Mos azhurnim[1] të PMK-së janë hasur edhe në katër raste tjera, ndërsa për një[2] kontratë nuk ishte përgatitur fare PMK.
- Te procedura e prokurimit për “Mirëmbajtjen e Objekteve Komunale” me vlerë indikative prej 94,412€, kryesuese e komisionit për vlerësimin e ofertave për këtë procedurë të prokurimit, ishte caktuar zyrtarja që kishte përgatitur specifikat, para masën dhe para llogarinë.

- Te kontrata për “Furnizim me material mjekësor (ampullar, laboratorik, stomatologjik, radiologjik dhe gjinekologjik)” me vlerë indikative prej 169,380€ menaxher i kontratës ishte caktuar zyrtari i depos, që në këtë rast përfshihet në më shumë se një fazë të procesit, atë të porosisë, menaxhimit të kontratës dhe pranimit të mallrave.
- Kontrata për “Ndihmë me pako ushqimore për familjet në gjendje të rëndë” në vlerë 59,976€, ishte përcjellë me mangësi. Me kontratë në përshkrim të çmimeve ishte specifikuar që produktet të jenë në kilogram, copë dhe litra. Dy produkte të pranuar nuk ishin në peshën e kërkuar me specifikacion. Ishin kërkuar 2,400kg oriz, ndërsa janë pranuar 2,400 qese me peshë 800g apo 480kg më pak, gjithashtu ishin kërkuar 1,200kg fasule ndërsa ishin pranuar 1,200 qese me nga 600g apo 480kg më pak.
- Kontrata e nënshkruar me dt. 03.04.2020 për “Dezinfektim, Deratizim dhe dezinfektim të objekteve në Obiliq”, në vlerë 25,000€, ishte planifikuar të realizohej në tre faza dhe afati i kontratës ishte caktuar vetëm 30 ditë. Shërbimet e dezinfektimit ishin realizuar në katër faza, ku dy fazat e fundit ishin realizuar pas skadimit të kontratës. Menaxheri i kontratës kishte bërë kërkesë për vazhdim të afatit në fazën e fundit të dezinfektimit, apo tre javë pas skadimit të kontratës.

Kjo situatë ishte si shkak i mosfunksionimit të kontrolleve dhe menaxhimit të dobët të projekteve apo kontratave të nënshkruar.

Ndikimi

Rastet e identifikuar tregojnë për kontrolle të pamjaftueshme rreth menaxhimit të kontratave, ku ato mund të mos zbatohen sipas kushteve kontraktuale dhe mund të shkaktojnë kosto të pa arsyeshme buxhetore. Përfshirja e një zyrtari në më shumë se në një fazë të procesit, bie ndesh me kërkesat ligjore dhe parimin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë se funksionojnë kontrollet në realizimin e kontratave në pajtim me kushtet kontraktuale. Menaxherët e kontratave të përgatitin planin për menaxhimin e kontratave dhe ta azhurnojnë me informata plotësuese rreth realizimit dhe përmbylljes së kontratës si dhe të mbajnë shënime në ditarin e punës dhe librin ndërtimor për punët e realizuara. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë se bëhet ndarje e drejtë e detyrave dhe përgjegjësive për zyrtarët të cilët janë pjesë e proceseve për të shmangur çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,113,741€, ishin shpenzuar 1,005,138€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me përfitues individualë, OJQ të ndryshme. Kemi testuar 11 mostra për teste substanciale në vlerë 160,266€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare / subvencionim

Gjetja Rregullorja MF 04-2017 Për subvencionimin e OJQ-ve”, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin e OJQ-ve. Neni 6, pika 1 - Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë ZKM.

Komuna nuk kishte përgatitur një Plan vjetor të përgjithshëm të mbështetjes financiare për OJQ-të. Një plan i mbështetjes financiare për OJQ ishte përgatitur vetëm nga drejtorja e kulturës, por jo edhe nga drejtoritë tjera.

Kjo situatë është si shkak i mungesës së kontrolleve efikase në përmbushjen e kërkesave për hartimin dhe raportimin e planit vjetor të subvencioneve dhe përmbushjen e kërkesave për raportim të planit në ZKM.

Ndikimi Mungesa e planit vjetor të subvencioneve pamundëson informimin me kohë të palëve të interesuara rreth programit vjetor dhe objektivave që synohen të arrihen përmes financimit të projekteve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-te.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Parregullsi në procesin e subvencionimit të OJQ-ve

Gjetja Komuna e Obiliqit ka të aprovuar Rregulloren për Subvencione përmes së cilës janë përcaktuar kërkesat dhe procedurat për subvencionim. Gjithashtu, Rregullorja MF 04 2017 për subvencionimin e OJQ-ve, ka përcaktuar procedurat, kërkesat dhe kriteret për subvencionimin. Përmes kësaj rregullore janë përcaktuar formularët dhe raportet që organizatat buxhetore duhet të aplikojnë përgjatë tërë procesit të subvencionimit.

- Nga lista e përfituesve, testuam dy projekte të financuara, për “Zhvillimin, afirmimin, promovimin e fluturimeve të lira në rritjen e vetëdijesimit të rinisë për një shëndet të mirë”, në vlerë 3,000€ dhe projektin “Organizimi i aktiviteteve sportive

të grup moshave të ndryshme për qëllime edukative”, në vlerë 3,500€ dhe kemi identifikuar se Komisioni vlerësues kishte hartuar një procesverbal rreth vlerësimit të aplikacioneve duke mos përdorur formularët zyrtarë të vlerësimit të aplikacioneve, mirëpo të dhënat e prezantuara ishin të mangëta dhe nuk shpjegonin mjaftueshëm informata për projektet e refuzuara, por edhe për ato që janë propozuar për financim.

- Për “Përkrahjen financiare të bizneseve për shkak të Pandemisë”, në vlerë totale prej 130,000€, ishte bërë një ftesë dhe ishte organizuar një takim me biznese, por jo ndonjë publikim të Thirrjes Publike në ueb faqe të Komunës, apo formë tjetër të informimit. Kriteret për pjesëmarrje nuk ishin përcaktuar paraprakisht, por ato ishin vendosur nga komisioni që ishte caktuar për shqyrtimin e dokumentacionit. Kriteret e vendosura ishin të përgjithësuara dhe vështirë të matshme. Ishin përcaktuar limitet e financimit për llojet e bizneseve, por në disa raste komisioni nuk i është përmbajtur atyre kriterëve. Një nga kriteret ishte që bizneset me veprimtari gastronominë të përfitojnë 600€, ndërsa sipas këtij kriteri kishin përfituar edhe bizneset tjera që nuk kanë zhvilluar aktivitetin e gastronomisë. Për disa biznese të refuzuara nuk janë dhënë informata të mjaftueshme për mos plotësim të kriterëve, dhe disa të tjera (nëntë raste) ishin refuzuar për shkak të aktivitetit të biznesit, ndonëse ishte vendosur edhe kriteri që çdo aplikues/biznese individual të përfitojnë 300€, pa përcaktuar ndonjë kufizim. Në fund të procesit, lista e përfituesve ishte publikuar në ueb faqe, por jo edhe shumat financiare sipas përfituesve.
- Pagesa në vlerë prej 20,000€ e dedikuar për kompanitë publike për mbështetje financiare për shkak të pandemisë, ishte regjistruar në kodin ekonomik subvencione për entitete jopublike, ndonëse përfitues ishte entiteti publik.

Arsyeja për këtë është mungesa e kontrolleve adekuate për të monitoruar procesin e subvencionimit, që ka rezultuar në mos zbatimin e kërkesave ligjore gjatë procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve për financim.

Ndikimi

Mos aplikimi i kërkesave të rregullores krijojnë parakushte që procesi të mos zhvillohet në mënyrë transparente dhe të mos arrihen objektivat e synuara. Gjithashtu regjistrimi i këtyre shpenzimeve në kodet jo adekuate ekonomike nuk ofron detaje për fondet e përfituar nga entitetet publike.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se procesi i përzgjedhjes së projekteve për financim të zhvillohet duke aplikuar të gjitha kërkesat dhe formatet/formularët standard të përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04/2017 për subvencionim të OJQ-ve. Përkrahjes financiare ti

paraprijë thirrja publike përmes së cilës përcaktohen qartë kriteret dhe kushtet tjera për pjesëmarrje që duhet të përmbushen nga përfituesit e mundshëm. Po ashtu, regjistrimi i shpenzimeve duhet të bëhet në kodet përkatëse të parapara në planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,621,592€, prej tyre ishin shpenzuar 4,375,666€. Investimet kapitale kanë të bëjnë kryesisht me rregullim/ndërtim të infrastrukturës, rregullim të shesheve, rregullim të parqeve, qendrës sociale, si dhe përmirësime të ndryshme tek objektet, inventar etj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale dhe pajtueshmëri në vlerë 2,897,983€ si dhe pesë mostra për proceduara të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Paradhënia (pagesa në avans) jo në pajtim me ligjin e buxhetit

Gjetja Sipas Ligjit nr. 07/L -001 për buxhetin e vitit 2020, neni 13 pagesat e paradhënies theksohet se organizatat buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në (15%) të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetë mijë (10,000€), e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Po ashtu sipas këtij neni, në muajin nëntor të vitit 2020 pagesa e paradhënies është e kufizuar deri në dhjetë për qind (10%) të vlerës së kontratës dhe në muajin dhjetor të vitit 2020 deri në pesë për qind (5%) të vlerës së kontratës.

Te kontrata “Ndërtimi i sheshit Adem Preniqi” me vlerë prej 989,026€ ishte bërë pagesa në avancë në muajin nëntor 15% e vlerës së kontratës, apo 148,353€, ndërsa ishte dashur të bëhet 10% e vlerës së kontratës apo 98,902€. Po ashtu edhe te kontrata “Kogjenerimi për ngrohjen e qytetit ne Obiliq” me vlerë të kontratës 917,917€ pagesa e avancit ishte bërë në muajin dhjetor 15% e vlerës së kontratës apo vlera prej 137,687€, ndërsa ishte dashur të bëhet 5% e vlerës së kontratës apo 45,895€.

Shkaku i ndodhjes se kësaj shtate ishte realizimi i pagesave në mënyrë që Komuna të ketë një performancë më të mirë tek realizimi i buxhetit dhe mjetet mos të shkojnë në deficit.

Ndikimi Pagesat e avanseve duke tejkaluar limitet e përcaktuar me Ligi ndikon në shpenzimin e parregullt dhe të pakontrolluar të parasë publike, dhe mund të reflektoj po ashtu me realizimin e dobët të punëve në të ardhmen.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj se pagesat e paradhënieve të bëhen në pajtim me Ligjin e Buxhetit, në mënyrë që mos të ketë pagesa përtej limiteve të lejuara sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Mungesa e projekteve ekzekutive me rastin e lëshimit të dosjes së tenderit

Gjetja Neni 28, pika 10 të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, përcakton “Për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë”, autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit dhe nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Komuna kishte nënshkruar nëntë kontrata për punë, në mungesë të projekteve ekzekutive. [1]

Shkaku i ndodhjes së kësaj është se Komuna nuk ka ushtruar kontrolle në hartimin e projekteve para fillimit të tenderimit të punëve.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv rezulton me anashkalim të kërkesës ligjore dhe mund të rezultojë me realizim të dobët të kontratave për punë të pa projektuara, studiuara të cilat mund të afektojnë shpenzime të paparashikuara apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi B5 Kryetari të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si: mallrat dhe shërbimet, dhe investimet kapitale;

Çështja A4 - Tejkalimi i pozicioneve të peshuara të kontratës dhe parregullsi në pagesë

Gjetja

Pika 56.15 te RRUOPP përcakton se kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshën në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje e veturave, mirëmbajtje e gjeneratorëve etj. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi.

Në shpjegimin e KRPP-së, nr. 68, përcaktohet që Autoritetet Kontraktuese duhet të luajnë një rol aktiv në përcaktimin sa më të saktë të vlerës së parashikuar e më këtë edhe vlerës së kontratës (të realizuar). Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që edhe sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë. P.sh nëse pesha është dhënë kategorive të artikujve apo shërbimeve duke u bazuar në raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport. Përfundimisht AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmojë në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK-ës.

- Te kontrata kornizë "Hartimi i projekteve detaje" me vlerë 275,210€ e lidhur në vitin 2019 sipas çmimeve për njësi në bazë të peshimit të artikujve, ku për pozicionin (h) punimi i elaborateve për nevojat të autoritetit kontraktues, ju ka dhënë pesha 20% këtij pozicioni, dhe sipas kësaj shuma që lejohet për tu shpenzuar për këtë pozicione është 55,042€. Ndërsa në tri mostra (pagesa) në vlerë 149,999€ kemi vërejtur se për këtë pozicion janë paguar 125,229€, pra kemi tejkalim të pozicionit.
- Kontrata kornizë tri vjeçare e lidhur me 21.05.2020 për "Mirëmbajtja e parqeve, hapësirave të gjelbëruara dhe shesheve", në vlerë të parashikuar prej 210,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi apo duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën

kategori/pozicion. Sipas LPP, kontratat me çmime për njësi aplikohen vetëm në rastet kur AK nuk dinë sasi të indikative, derisa për këtë kontratë Komuna kishte informacione për sasinë indikative siç edhe janë dhënë në përshkrimin teknik në aneksin 1 të dosjes së tenderit. Specifikacioni teknik ishte ndarë në pesë kategori kryesore, të peshuar sipas rëndësisë me 20% secili prej tyre. Për 10 muajt e parë të realizimit të kontratës (nga qershori 2020 deri në mars 2021) janë kryer pagesa në total prej 134,953€. Vetëm nga kategoria e parë që ishte peshuar 20% janë paguar 114,217€, apo 85% e total pagesave për këtë kontratë ($114,217/134,953=85\%$), duke e humbur raportin ndërmjet sasisë së realizuar dhe peshës së dhënë.

Gjithashtu, në tri situacione të punimeve, kemi gjetur se pozicioni “1.1 – Mbledhja e mbeturinave etj, 1.2 - Fshirja dhe larja e kubëzave gjatë verës dhe pastrimi i borës etj,” përveç që ishin përfshirë në kategorinë 1 – Mirëmbajtja e Parqeve, ishin përfshirë edhe në kategorinë 3 – Kositja e Barit, dhe vlera e mbivlerësuar dhe e paguar në total ishte 12,737€. Menaxheri i kontratës nuk ka ofruar ndonjë sqarim pse është përsëritur i njëjti pozicion.

Përveç kësaj, në situacione të punëve ishin përfshirë edhe hapësira tjera (rrugë, parqe) që nuk ishin planifikuar me kontratë, dhe sasia e tyre ishte e konsiderueshme dhe me ndikim thelbësor në sasinë dhe vlerën e parashikuar të kontratës. Si rezultat i kësaj, për 10 muajt e parë, ishte realizuar 65% vlerës totale të parashikuar në kontratë ($134,953/210,000=65\%$).

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të nevojave nga njësia kërkuese dhe mungesës së kontroleve adekuate në menaxhimin e kontratave dhe certifikimit të pagesave.

Ndikimi

Ndryshimi i raportit të peshave për kategori, midis atij të kontraktuar dhe të paguar, rezulton me shpenzime të parregullta dhe mund të përcillet edhe me kosto shtesë për shkak se raporti i peshimit që ka shërbyer për përcaktimin e ofertës me çmim më të ulët, nuk është ruajtur edhe për pagesë. Pozicionet e përsëritura reflektojnë me humbjen dhe shpenzimin e paarsyetuara të parasë publike. Gjithashtu mirëmbajtja e hapësirave shtesë të pa kontraktuara ndikojnë negativisht në realizim të kontratës dhe planet e organizatës.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se në rastet kur aplikohen procedurat e prokurimit për kontratat me çmime për njësi, pesha të përcaktohet në bazë të rëndësisë që ka secila kategori e shërbimeve ose secili artikull, në mënyrë që të përcaktohet oferta më e lirë. Gjithashtu, të

sigurojë ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes nga menaxherët e kontratave, dhe rritjen e cilësisë së planifikimeve të nevojave nga njësitë kërkuese. Mekanizmat e kontrollit të përforcohen edhe në certifikim të pagesave, me qëllim evitimin e pagesave të parregullta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Krijimi i urdhër blerjeve pas skadimit të kontratave

Gjetja

Neni 12 i Rregullës Financiare 01-2013-për Shpenzimin e parasë publike, përcakton që zotimi është njohje kontabël në SIMFK e një obligimi të mundshëm në të ardhmen për të bërë një shpenzim të parave publike, ndërsa neni 17 përcakton që Urdhërblerja krijohet dhe përgatitet nga ana e OB, pas zgjedhjes së ofertuesit me të cilin është nënshkruar kontrata.

- Për kontratën e nënshkruar me dt. 20.11.2020 “Furnizim me teste serologjike për SARS COV-2“ në vlerë 131,727€, urdhër blerja ishte përgatitur (08.12.2020) dhe nënshkruar pas skadimit të kontratës, si dhe pas pranimit të furnizimeve. Liferimi i mallrave (i paraparë me nënshkrimin e kontratës në afat prej 10 ditëve) gjithashtu ishte bërë me vonesë dhe për këtë nuk ishin aplikuar as penalet që parashihen në kontratë prej 0.25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara.
- Për kontratën e nënshkruar me dt.22.04.2020 “Furnizim me Sera” në vlerë 36,700€, urdhër blerja është përgatitur (16.07.2020) dhe nënshkruar 45 ditë pas skadimit të kontratës (kohëzgjatja e kontratës 40 ditë nga data kur është hyrë në fuqi kjo kontratë apo kur është nënshkruar), apo pas pranimit të punimeve (13.07.2020).
- Gjithashtu, nga shqyrtimi i mostrave të përzgjedhura për auditim, kemi gjetur se në, 10 raste zotimi i mjeteve në SIMFK dhe përgatitja e urdhërblerjeve ishte bërë pas pranimit të faturës apo pranimit të mallrave apo shërbimeve.

Mungesë e kontrollit dhe mbikëqyrjes si në përgatitjen e urdhërblerjeve nga zyrtari i prokurimit ashtu edhe në menaxhimin e buxhetit dhe zotimit të mjeteve me kohë në SIMFK ishte shkak pse ka ndodhë kjo situatë.

Ndikimi

Përgatitja e urdhërblerjes pas skadimit të kontratës krijon paqartësi rreth implementimit të kontratës, dhe bie ndesh me kushtet kontraktuale. Kjo mund të shkaktojë gjithashtu kosto shtesë buxhetore në rast të padive dhe procedurave të përmbarrimit nga kontraktuesit për mos pagesë me kohë të detyrimeve në mungesë të buxhetit.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të siguroje se zyra e prokurimit pas nënshkrimit të kontratës përgatitë dhe dërgon me kohë urdhrin për blerje, e cila së bashku me zotimin e mjeteve financiare në SIMFK i paraprijnë furnizimit të mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu duhet të siguroje se aplikohen ndëshkimet në rastet kur vonesat në realizim të kontratës nuk arsyetohen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor i cili është edhe Drejtor i njësisë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), në Komunën e Obiliqit në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2020, kishte planifikuar gjashtë (6) auditime të rregullta (tri me rrezik të lartë, dhe tri me rrezik të mesëm). Plani vjetor ishte bërë në bazë të vlerësimit të rreziqeve dhe prioriteteve. Gjatë vitit 2020 NjAB kishte arrit që ti përfundoj tri auditime, këto auditime kishin të bënin me aktivitetet e vitit 2019 dhe 2020.

Auditimet e përfunduar ishin: për procedurat e prokurimit, të hyrat në drejtorinë e shëndetësisë dhe auditimin e tatimit në pronë. Komiteti i Auditimit (KA), ka mbajtur pesë takime gjatë vitit 2020 ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së, dhe është diskutuar për raportet e ZKA-së.

Çështja A6 - Mos përmbushja e planit vjetor nga NJAB-i

Gjetja Sipas Planit vjetor të NJAB-se që është aprovuar nga menaxhmenti i komunës dhe komiteti i auditimit me dt. 30.12.2019, kjo njësi kishte planifikuar që të realizonte gjashtë auditime për vitin 2020.

NJAB kishte arritur që ti përfundojë tri auditime, ndërsa fushat të cilat nuk i kishte audituar kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive (në sektorin e buxhetit dhe financave), të hyrat (në sektorin e ekonomisë, gjendjes civile, sektorin e sportit dhe kulturës) dhe shpenzimet (në sektorin e buxhetit dhe financave), të cilat ishin planifikuar si auditime me prioritet të lartë, nga vet kjo njësi.

Shkaku për se nuk është realizuar plani ishte puna me staf të reduktuar gjatë vitit 2020 për arsye të pandemisë.

Ndikimi Mos përmbushja e planit vjetor të auditimit ndikon negativisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit në Komunë dhe në arritjen e objektivave të saj.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj se NJAB do të angazhohet që të përmbushë planin e auditimit në mënyre që ti ofroj menaxhmentit një pasqyrë të qartë rreth funksionimit të organizatës ku pastaj të ketë mundësi që ti marrë masat për ti korrigjuar gabimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve nga kategoritë ekonomike dhe të hyrat e mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	11,437,447.00	12,615,364.42	10,711,190.91	10,736,831.59	6,387,148.10
Grante Qeveritare – Buxheti	10,414,782.00	10,608,764.78	9,330,098.53	9,849,469.72	5,613,954.08
Financimi përmes huamarrjes	0.00	59,535.00	59,535.00	5,189.60	3,550.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	913,999.44	631,929.13	398,312.35	169,938.09
Të hyrat vetanake	1,022,665.00	1,022,665.00	680,088.09	478,177.54	530,366.55
Donacionet vendore	0.00	860.00	0.00	5,682.38	13,502.00
Donacionet e jashtme	0.00	9,540.20	9,540.16	0.00	55,837.38

Buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar është rritur për 1,177,917€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar 913,999€, nga granti i qeverise 193,982€, nga huamarrja 59,535€, nga donacionet e jashtme 9,540€, si dhe nga donacionet e brendshme 860€

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 85% të buxhetit final ose 10,711,191€, pothuajse në nivel të njëjtë me vitin e kaluar 2019 (që ishte 84%). Megjithatë, se si është realizuar buxheti në nivel të kategorive, janë dhënë shpjegimet në tabelën më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	11,437,447.00	12,615,364.42	10,711,190.91	10,736,831.59	6,387,148.10
Pagat dhe mëditjet	4,078,259.00	4,273,538.39	4,229,433.39	3,908,948.80	3,833,180.89
Mallrat dhe shërbimet	823,930.00	1,289,497.97	891,320.84	717,363.77	520,242.07
Komunalitë	316,675.00	316,994.84	209,632.75	246,322.79	148,160.61
Subvencionet dhe transferet	762,800.00	1,113,740.87	1,005,138.36	632,160.93	139,929.69
Investimet Kapitale	4,912,981.00	5,621,591.90	4,375,665.57	5,232,035.30	1,745,634.84
Rezervat	542,802.00	0.45	0.00	0.00	0.00


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve në raport me atë fillestar është rritur për 195,279€, rritja ka ndodhur nga të hyrat e bartura dhe nga Huamarrja.
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve buxheti final në raport me atë fillestar është rritur për 465,568€, rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga rezerva, me vendimet e Qeverisë nr.11/30 për Rimëkëmbja Ekonomike, dhe nga donacionet e jashtme. Përkundër kësaj, realizimi i buxhetit ishte në nivel vetëm 69% për shkak të gjendjesë e pandemisë ku nuk ishin realizuar disa shpenzime.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar është rritur prej 350,941€. Kjo rritje ishte si rezultat i bartjes së të hyrave nga viti i kaluar në vlerë prej 50,411€, nga kategoria e rezervës 100,000€ si dhe me vendimet Qeverisë nr.11/30 të dt.14.09.2020 për Rimëkëmbje ekonomike për COVID 19 në vlera prej 200,530€.
- Po ashtu, edhe buxheti final për investime kapitale është rritur për 708,610€. Kjo si rezultat i bartjes së të hyrave nga viti i kaluar në vlerë prej 625,398€, nga kategoria e rezervës 124,317€, nga donacionet e brendshme 860€ si dhe donacionet e jashtme në vlerë 7,380€, po ashtu me vendimin e Qeverisë buxheti ishte zvogëluar në vlerë prej 49,345€. Përkundër buxhetit final në dispozicion, realizimi ishte në nivel prej 78%, sepse deri në muajin prill 2020, Qeveria kishte ndaluar shpalljen e tenderimeve për shkak të situatës pandemike.
- Buxheti final në raport me atë fillestarë te kategoria e rezervës ka mbetur zero, sepse nga kjo kategori për mallra dhe shërbime janë destinuar 215,117€, për subvencione dhe Transfere 100,000€ dhe për investime kapitale 124,314€.


Komuna për menaxhimin e pandemisë Covid-19 kishte shpenzuar buxhet në vlerë prej 678,437€, prej tyre 182,385€ ishin shtesa në paga, 238,006€ mallra dhe shërbime si dhe 258,046€ subvencione dhe transfere.

Detyrimet kontraktuale të raportuara nga ana e Komunës në fund të vitit 2020 janë në vlerë prej 4,154,980€.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga Komuna ishin në vlerë 776,820€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, të hyrat nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë etj. Po ashtu, Komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra nga gjobat në trafik, në vlerë totale prej 104,348€, këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	1,022,665.00	1,022,665.00	776,820.13	972,594.24	917,275.26
Të hyrat tatimore	451,399.00	451,399.00	362,266.65	485,616.44	431,175.13
Të hyrat jo tatimore	571,266.00	571,266.00	414,553.48	486,977.80	486,100.13

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të komunës së Obiliqit ka rezultuar me shtatë rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna si dhe është angazhuar për ti adresuar ato. Po ashtu komuna ka përgatitur edhe progresin rreth zbatimit të rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, një rekomandim ishte zbatuar, pesë nuk ishin zbatuar ende dhe një konsiderohet si i mbyllur, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që nga drejtoria përkatëse janë ndërmarr të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj subjekteve afariste të cilët nuk i përmbushin obligimet dhe të inicohen procedura gjyqësor nëpërmes gjykatës apo përmbauesve për t'i mbledhur ato.	Komuna nuk kishte marre masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese bëjnë planifikime më reale të nevojave për furnizim, dhe se menaxherët e kontratave nuk lejojnë furnizimin përtej limiteve të përcaktuara me kontratën publike kornizë.	Komuna nuk kishte marre masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i subvencionimit përmes thirrjes publike dhe përcaktimi i kriterëve bëhet në përputhje me afatet dhe kërkesat e rregullores për subvencionimin e OJQ-ve.	Komuna nuk kishte marre masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht se njësitë kërkuese kanë të hartuar projektin ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e ligjore.	Komuna nuk kishte marre masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se aplikohen të gjitha procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, sa i përket ndarjes së drejtë të detyrave gjatë procesit të prokurimit, për shmangien e çfarëdo konfliktit të mundshëm.	Komuna nuk kishte marre masa për ta adresuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Keq klasifikim i shpenzimeve	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Komuna kishte marre pjesërisht masa për ta adresuar këtë rekomandim, nga kategoria e investimeve nuk kemi pasur rastet e keqklasifikimit, ndërsa nga mallrat dhe shërbimet për paga edhe me tutje ka rastet. Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është i aplikueshëm më

7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara në bazë të faturimeve dhe që vlera e tyre shpaloset saktë në PFV pas harmonizimit të regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në.	Komuna kishte marre masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar
----	-------------------------	--	--	-----------

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave mbi pronën për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të monitoroj realizimin efektiv të të hyrave duke analizuar shkaqet e rritjes së llogarive të pa arkëtuara dhe me raste, të sigurojë që të iniciohen procedura nëpërmes gjykatës apo përmbaruesve për ti mbledhur borxhet nga bizneset.
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që plani i prokurimit do të përfshijë të gjitha kërkesat nga njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit, dhe në raste specifike kur aktiviteti nuk është përfshirë në plan, parapraktisht të njoftohet AQP. Po ashtu, kryetari të sigurojë që kërkesat nga njësitë kërkuese të planifikohen në bazë të nevojave reale si dhe furnizimet përmes kontratave publike kornizë të mos tejkalojnë limitet e lejuara të devijimit prej +/-30%.
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se funksionojnë kontrollet në realizimin e kontratave në pajtim me kushtet kontraktuale. Menaxherët e kontratave të përgatitin planin për menaxhimin e kontratave dhe ta azhurnojnë me informatat plotësuese rreth realizimit dhe përmbylljes së kontratës si dhe të mbajnë shënime në ditarin e punës dhe librin ndërtimor për punët e realizuara. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë se bëhet ndarje e drejtë e detyrave dhe përgjegjësi për zyrtarët të cilët janë pjesë e proceseve për të shmangur çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit.
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-te, dhe raportimin e planit në ZKM në afatin e përcaktuar.
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i përzgjedhjes së projekteve për financim të zhvillohet duke aplikuar të gjitha kërkesat dhe formatet/formularët standard të përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04 2017 për subvencionim të OJQ-ve. Përkrahjes financiare ti paraprijë thirrja publike përmes së cilës përcaktohen qartë kriteret dhe kushtet tjera për pjesëmarrje që duhet të përmbushen nga përfituesit e mundshëm. Po ashtu, regjistrimi i shpenzimeve duhet të bëhet në kodet përkatëse të parapara në planin kontabël.
7.	Investimet kapitale	Kryetari të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.
8.	Investimet	Kryetari duhet të siguroj se pagesat e paradhënieve të bëhen në pajtim

	kapitale		me Ligjin e Buxhetit, në mënyrë që mos të ketë pagesa përtej limiteve të lejuara sipas kërkesave ligjore.
9.	Çështjet përbashkëta	e	Kryetari duhet të sigurojë se në rastet kur aplikohen procedurat e prokurimit për kontratat me çmime për njësi, pesha të përcaktohet në bazë të rëndësisë që ka secila kategori e shërbimeve ose secili artikull, në mënyrë që të përcaktohet oferta më e lirë. Gjithashtu, të sigurojë ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes nga menaxherët e kontratave, dhe rritjen e cilësisë së planifikimeve të nevojave nga njësitë kërkuese. Mekanizmat e kontrollit të përforcohen edhe në çertifikim të pagesave, me qëllim evitimin e pagesave të parregullta.
10.	Çështjet përbashkëta	e	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit pas nënshkrimit të kontratës përgatitë dhe dërgon me kohë urdhrin për blerje, e cila së bashku me zotimin e mjeteve financiare në SIMFK i paraprijnë furnizimit të mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu duhet të sigurojë se aplikohen ndëshkimet në rastet kur vonesat në realizim të kontratës nuk arsyetohen.
11.	Auditimi Brendshëm	i	Kryetari duhet të sigurojë se NJAB do të angazhohet që të përmbushë planin e auditimit në mënyrë që ti ofroj menaxhmentit një pasqyrë të qartë rreth funksionimit të organizatës ku pastaj të ketë mundësi që ti marrë masat për ti korrigjuar gabimet.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndhmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Luljeta Morina, Udhëheqëse e Auditimit



Lavdim Maxhuni, Udhëheqës i ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Ilir Abazi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Obiliqit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Xhafer Gashi 
Kryetar i Komunës së Obiliq
Data: 06.07.2021, Obiliq

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁹ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionit i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

të përfshihet menjëherë pas opinionit;

të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;

të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe

- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik.
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja.
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Kontrata për DDD – Menaxhimi i COVID-19 në institucionet publike komunale në vlerë 5,000€. Kontrata për Furnizim me Sera në vlerë 36,700€. Kontrata për Furnizim me teste serologjike për SARS COV 2 në vlerë 1312,727€. Kontrata për Ndihmë në pako ushqimore për familjet në gjendje të rëndë në vlerë 59,976€. Kontrata për Furnizim me centrifuga elektrike për vjeljen e mjaltit, në vlerë 15,552€.
- ⁶ Implementimi I sistemit solar me vlerë të kontratës 16,395€; Asfaltimi I rrugëve Musli Krasniqi-Siboc me vlerë të kontratës 68,892€; Asfaltimi I rrugëve Ilaz Hashani segmenti 1,2,3 me vlerë të kontratës 162,308€; Asfaltimi I rrugëve Obiliq qendër dhe nën hekurudhë me vlerë të kontratës 385,452€; Ndërtimi I rrugëve me kubëza me vlerë të kontratës 162,911€; Rregullimi I rrethojës te sheshi Adem Preniq me vlerë të kontratës 6,995€; Asfaltimi I rrugëve Kuvendi I Arbërit me vlerë të kontratës 156,823€; Asfaltim I rrugëve Shefqet Mjeku - Shipitullë me vlerë të kontratës 36,246€.
- ⁷ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit.
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.